



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LIGJI Nr. 03/L-217

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.03/L-037
PËR DOKUMENTET E UDHËTIMIT**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.03/L-
037 PËR DOKUMENTET E UDHËTIMIT**

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Neni 2 i ligjit në fuqi, pas perkufizimit „të dhënat personale“ i shtohen edhe katër perkufizime të reja si vijon:

“**Libreza detare**” - është dokument i vlefshëm i udhëtimit i pajisur me vizë që i lëshohet anëtarit të ekuipazhit të mjetit lundrues, anijes për lundrim jashtë shtetit”

“**Viza**” - nënkupton lejen për hyrje, kalim transit në shtetin e caktuar, për të hyrë në territorin e tij dhe për të qëndruar për një afat të caktuar kohor në bazë të kërkesës së një shtetasi, e cila në formë të fletëngjithëses i vendoset në dokumentin e tij /saj të udhëtimit.

“ONAC” – organizata ndërkombëtare e aviacionit civil.

“SLDH” – struktura logjike e të dhënave.

Neni 2

Neni 3 i ligjit në fuqi riformulohet si vijon:

Pasaporta është dokument që përmban të dhënat personale, në formë fizike dhe elektronike, që i lëshohet shtetasit të Republikës së Kosovës për të kaluar kufirin shtetëror dhe për të vërtetuar identitetin dhe shtetësinë e bartësit të dokumentit.

Neni 3

Neni 4 i ligjit në fuqi riformulohet si vijon:

Shtetasi i Republikës së Kosovës ka të drejtë të ketë vetëm një dokument udhëtimi të llojit të njejtë.

Neni 4

Neni 7 i ligjit në fuqi pas pikës f) shtohet shtohet një pikë e re g) si vijon:

g) Libreza detare

Neni 5

Neni 12 i ligjit në fuqi riformulohet si vijon:

12.1. Fletudhëtimi-Dokumentin e udhëtimit për kthim e lëshon misioni diplomatik apo konsullor i Republikës së Kosovës për shtetasit që kanë mbetur pa dokument udhëtimi jashtë shtetit apo i ka skaduar afati i vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit.

12.2. Misioni diplomatik apo konsullor nga paragrafi 12.1. i këtij neni, duhet të verifikojë identitetin, statusin e qëndrimit të shtetasit të cilit duhet t'i lëshohet fletudhëtimi për kthim.

Neni 6

Neni 14 i ligjit në fuqi, paragrafi 14.2. riformulohet si vijon:

14.2. Dokumenti i udhëtimit përmban këto të dhëna:

- a) Emrin e shtetit;
- b) Stemën e shtetit
- c) Llojin e Dokumentit të Udhëtimit;
- d) Kodin e Dokumentit;
- e) Kodin e shtetit;
- f) Numrin serik të dokumentit të udhëtimit;
- g) Mbiemrin;
- h) Emrin;
- i) Shtetësinë;
- j) Datëlindjen;
- k) Numrin personal;
- l) Gjininë;
- m) Vendin e lindjes;
- n) Gjatësinë;
- o) Ngjyrën e syve;
- p) Datën e lëshimit ;
- q) Autoritetin e lëshimit;
- r) Datën e skadimit;
- s) Nënshkrimin;
- t) Fotografinë e bartësit.

Neni 7

Neni 15 i ligjit në fuqi riformulohet si vijon:

15.1. Formularët dhe dokumentet e udhëtimit të pa personalizuara shtypen sipas Ligjit për përdorimin e Gjuhëve në Republikën e Kosovës.

15.2. Personalizimi i dokumenteve të udhëtimit bëhet në alfabetin latin.

Neni 8

Neni 18 i ligjit në fuqi pas paragrafit 18.1. shtohet një paragraf i ri 18.2. si vijon:

18.2. Libreza detare lëshohet në afat vlefshmërie prej dy (2) vitesh

Neni 9

Neni 23 i ligjit në fuqi pas paragrafit 23.7. shtohet një paragraf i ri 23.8. si vijon:

23.8. Të gjitha të dhënat ne dokumentet e udhëtimit ruhen në çip në formë elektronike, duke përfshirë edhe gjurmët e gishtërinjve sipas “SLDH” në bazë të standardit ONAC.

Neni 10

Neni 29 i ligjit në fuqi riformulohet si vijon:

Për ankesën kundër vendimit për refuzimin e kërkesës për lëshimin e pasaportës ose për marrjen e pasaportës që e ka lëshuar organi kompetent apo misioni diplomatik konsullor vendos Qeveria e Republikës së Kosovës

Neni 11

Neni 34 i ligjit në fuqi pika b) fshihet, ndërsa pika ekzistuese c) rinumërohet tani si pikë b).

Neni 12

1. Neni 35 i ligjit në fuqi paragrafi 35.1. pika a) fshihet, ndërsa pikat ekzistuese b) dhe c) rinumërohen tani si pika a) dhe b).

2. Neni 35 i ligjit në fuqi paragrafi 35.2. fshihet, ndërsa paragrafi 35.3. rinumërohet si paragraf 35.2.

Neni 13

Neni 38 i ligjit në fuqi riformulohet si vijon:

Dokumentet e udhëtimit të lëshuara nga Republika e Kosovës mund të përdoren deri në skadimin e afatit të vlefshmërisë së tyre.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-217
7 tetor 2010

Anëtari i Kryesisë së Kuvendit

Xhavit HALITI